REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorëzuar Primljeno/Predato Recieved/Delivery | 12.10 | 2018 viti god year | |
|---|---|---|---|
| Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No: | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Količina Quantity |
| SKPMSHCK | 5972/2018 | | 1/3 |

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova – Republic of Kosovo
### Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
### Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
### Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

**A.nr.566/2018**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Lulzim Aliaj, kryetar, Gjylinaze Gola dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë si dhe Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.566/2018 të datës 06.09.2018 të ankuesit Muharrem Sylmetaj nga fshati Gërçinë Rr.''Rexhep Sylmetaj'' p.n, në Gjakovë, kundër organit të punësimit Gjykata Themelore në Gjakovë në çështjen juridike „kontestim konkursi" dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 11.10.2018 mori këtë

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.566/2018 e datës 06.09.2018 e parashtruar nga ankuesi Muharrem Sylmetaj.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi KA.nr.18/2018 i datës 09.09.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Gjykatës Themelore Gjakovë.

## Arsyetim

Gjykata Themelore në Gjakovë me datë 04.07.2018 ka shpallur konkursin për pozitën „*Recepcionist''* në Gjykatën Themelore në Gjakovë, sipas autorizimit të Ministrisë së Administratës Publike/Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil të datës 28.06.2018.

Ankuesi Muharrem Sylmetaj ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Gjykata Themelore në Gjakovë për pozitën „ *Recepcionist''*.

Me datë 27.07.2018 përmes e-mailit zyrtar është njoftuar se i është refuzuar aplikacioni nga Komisioni përzgjedhës gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për formimin e listës së ngushtë të datës 25.07.2018, me arsyetim se nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të vazhduar procedurën e rekrutimit për pozitën „*Recepcionist''* në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 27.07.2018 ka parashtruar ankesë me datë 01.08.2018 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjakovë me datë 09.08.2018, ka nxjerr vendim me numër protokolli KA.nr.18/2018 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.



REPUBLIKA E ... KËSHILLI I PAVARUR ... SHËRBIMIN CIVIL ...

Ankuesi Muharrem Sylmetaj i pakënaqur me Vendimin e datës 09.08.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjakovë, me datë 06.09.2018, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 5094/2018 me pretendimet ankimore se Komisioni Përzgjedhës dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjakovë, nuk ka bërë analizimin e secilës provë veç e veç dhe nuk ka dhënë arsyetim për refuzimin e aplikacionit dhe ankesës së datës 01.08.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 14.09.2018 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Me datë 26.09.2018 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Gjykata Themelore në Gjakovë me shkresat e bashkëngjitura faqe 1/79.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën në Këshill me numër A.nr.566/2018 me datë 06.09.2018 të protokolluar me numër 5094/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shpallja e Konkursit Nr.6/2018 e datës 04.07.2018 deri me datë 18.07.2018; Vendimi KAnr.18/2018 i datës 09.08.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Autorizimi i datës 28.06.2018 nga Ministria e Administratës Publike/Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil; Përgjigje në ankesë e datës 26.09.2018; Kërkesë për punësim i datës 17.07.2018 Ernis Dervishi, vërtetimi i datës 10.07.2018, Pasqyra e llogarisë së Trustit, Letër rekomandimi i datës 10.07.2018, Letër rekomandimi i datës 11.07.2018, Diplomë e datës 18.06.2008 me numër të noterit LRP.nr.3258/2018; Testi me shkrim datë 31.07.2018; Formularët e vlerësimit të datës 31.07.2018; Kërkesë për punësim e datës 09.07.2018 e Muharrem Sylmetaj, Diplomë e datës 26.12.2017 me numër të noterit LRP.nr.416/2018, Diplomë e datës 21.09.2016, me numër të noterit LRP.nr.10203/2016, Diplomë e datës 26.08.1994, Certifikatë e datës 05.01.2018, Referencë e datës 15.01.2018, Referencë e datës 12.02.2018, Referencë e datës 09.01.2018; Raporti përmbledhës; Renditja përfundimtare e datës 01.08.2018; Raporti final me rekomandim nga komisioni rekrutues i datë 08.08.2018; Lista e ngushtë e datës 25.07.2018; Regjistri i aplikacioneve i datës 19.07.2018; Përcaktimi i kritereve për përfshirje në listën e ngushtë; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e datës 01.08.2018; Përcaktimi i kritereve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj e datës 31.07.2018; Vendimi i datë 23.07.2018; Propozim për emërimin e komisionit përzgjedhës i datës 23.07.2018; Njoftim i datës 27.07.2018 nga testi me shkrim si dhe shkresat e tjera të bashkëngjitura lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit Muharrem Sylmetaj ***është e pabazuar.***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Komisioni Përzgjedhës dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore në Gjakovë, nuk ka bërë analizimin e secilës provë veç e veç me rastin e refuzimit të aplikacionit dhe refuzimit të ankesës së datës 01.08.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se konkursi është shpallur me datë 04.07.2018 për pozitën *„Recepcionist''* në Gjykatën Themelore në Gjakovë, me kohëzgjatje deri me 18.07.2018. Komisioni përzgjedhës me datë 25.07.2018 e ka formuar listën e ngushtë, ku kriteret e konkursit, kanë qenë:
*-Arsimim i mesëm, trajnim përkatës dhe së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se komisioni përzgjedhës i shërbimit civil të Kosovës me rastin e mos përfshirjes në listën e ngushtë të ankuesit Muharrem Sylmetaj me datë 25.07.2018 ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1dhe 1.2 si dhe nenin 2 të Rregullores 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil ku përcaktohet se: ***"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: ''arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës dhe elementet e tjera të meritës"***, kurse me paragrafin 2 përcaktohet se: ***„Secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter, numri maksimal i secilit kriter është 20, pikë. Numri maksimal i pikëve është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidateve në procedurat e mëtejme është 40 pikë''.***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi në shkresat e lëndës, lidhur me përvojën e punës, ka dorëzuar dëshmitë në bazë të të cilave, dëshmohet se ankuesi ka vijuar punën praktike nga data 10.01.2017 deri me datë 09.01.2018 në Gjykatën Themelore në Gjakovë, dhe duke marr parasysh që kriteret e konkursit kanë qenë që kandidati të ketë Arsimim e mesëm, trajnim përkatës dhe së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative, konstatohet që ankuesi nuk ka përmbushur kriteret e konkursit lidhur me përvojën e punës, për përfshirje në listën e ngushtë dhe në këtë procedurë të rekrutimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Gjykatës Themelore të Gjakovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.18/2018 të datës 09.08.2018 ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike**: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**
**Lënda A.nr.566/2018**

**Lulzim ALIAJ**
**Kryetar i Kolegjit**

**Zyle Millaku -GOJNOVCI**
**Procesmbajtës**

***Vendimi i dërgohet:***

- *Ankuesit Muharrem Sylmetaj;*
- *Kryetarit të Komunës së Gjykatës Themelore në Gjakovë;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Themelore në Gjakovë;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*